

# AKT THEMELIMI

## SHOQËRIA TREGTARE

### “VËLLEZËRIT BARDHI”

Sh.p.k

TIRANË / SHQIPËRI

**DATË 23.09.2023**

#### NENI 1 FORMA

Formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në vecanti, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, si dhe me përcaktimet e këtij statuti.

#### NENI 2 EMRI

1. Emri i shoqërisë është **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.**

Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj e cila do të përbëhet nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT.

#### NENI 3 ORTAKËT

1. Shoqëria **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.** është shoqëri me 4 (kater) ortakë.
2. Ortaket e shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.** janë :
  1. **Z. Agim Bardhi** lindur me 28.11.1965, lindur ne Xiber-Murriz, Burrel dhe banues Tirane me adrese : Rruga "Nazmi Rushiti", Nr.4, Babrru, Njesia Administrative Paskuqan, 1047, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal G51128073W.
  2. **Z. Arben Bardhi** lindur me 17.06.1979, lindur ne Burrel, Burrel dhe banues Tirane me adrese : Rruga "Konferenca e Mukjes", Nr.20, Babrru, Njesia Administrative Paskuqan, 1047, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal H90617081W.

3. Z. Besnik Bardhi lindur me 11.08.1988, lindur ne Xiber, Burrel dhe banues Tirane me adrese : Rruga "Nazmi Rushiti", Nr.4, Babrru, Njesia Administrative Paskuqan, 1047, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal I80811098P.
  4. Z. Arjan Bardhi lindur me 27.07.1995, lindur ne Xiber, Burrel dhe banues Tirane me adrese : Rruga "Halit Haxhia", Nr.23, Koder e Kuqe, Njesia Administrative Paskuqan, 1047, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal J50727141F.
3. Shoqëria sipas vendimarrjes së ortakut të vetë të shoqërisë ose sipas vendimit të Asambles së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas rregullave/procedurave të këtij statuti dhe/ose dispozitave ligjore në fuqi mund të bëhet shoqëri me më shumë se një ortak.
4. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëhere ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëhere ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsiper nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

NENI 4 SELIA

1. Selia e shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.** ndodhet me adresë: **Rruga Konferenca e Mukjes, godine 1-kateshe ne ZK 1066, Nr.Pas 352/2, Bashkia Kamez, Shqipëri.**
2. Trasferimi i selisë së shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.** në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim.
3. Shoqëria **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.** mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi.

NENI 5 OBJEKTI

1. Shoqëria **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k** ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar:
  - a. Import-eksport, tregtim me pakice dhe shumice, transport e tregtim te materialeve te ndertimit e mallrave te ndryshem, ushqimore, makineri e pjese kembimi, pajisje elektrike, elektronike, hidraulike, lende te para, materiale ndertimi, inerte, produkte te gatshme e gjys te gatshme, sherbime ne fushen e ndertimit, germime, konfeksione, duralumin, xhelateri, agjensi publicitare, imobiliare, tabako, makina me qera.

NENI 6 KOHËZGJATJA

1. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDH” Sh.p.k.** është e pakufizuar.
2. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDH” Sh.p.k.** fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

NENI 7 KAPITALI

1. Kapitali bazë i shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDH” Sh.p.k.** është 100 000 (njëqindmijë) lek qe do te paguhet nga ortakët e shoqërisë sipas pjesmarrjes në kapital e

shoqërisë.

2. Kontributi i ortakut/ëve përbëjnë kapitalin themletarë dhe të regjistruar të shoqërisë  
**“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.**

3. Kapitali shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.**, ndahet në 4 kuota  
NENI 8 KONTRIBUTET NË KAPITAL

1. Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakut/ëve si më poshtë vijon:

**a.Z. Agim Bardhi zotëron 46% kapitalin e shoqërisë, me vlere 46 000 leke.**

**b.Z. Arben Bardhi zotëron 34% kapitalin e shoqërisë, me vlere 34 000 leke.**

**c.Z. Besnik Bardhi zotëron 10% kapitalin e shoqërisë, me vlere 10 000 leke.**

**d.Z. Arjan Bardhi zotëron 10% kapitalin e shoqërisë, me vlere 10 000 leke.**

2. Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortakët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi.

3. Administratori dhe sipas nevojës mund të marrë vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrimit të Barrave të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim.

4. Çertifikata e lëshuar sipas pikës 2 të këtij neni në emër të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci.

5. Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, nga

ortaku/ët e shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.**

NENI 9 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

1. Organet e shoqërisë **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.**, janë si më poshtë vijon:

a) Asambleja e Përgjithshme;

b) Adminstratori/et.

NENI 10 ADMINISTRIMI

5. Shoqëria **“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.** administrohet nga administratori **Z. Arjan Bardhi lindur me 27.07.1995, lindur ne Xiber, Burrel dhe banues Tirane me adrese : Rruga "Halit Haxhia", Nr.23, Koder e Kuqe, Njesia Administrative Paskuqan, 1047, Bashkia Kamez, madhor me zotesi te plote per te vepruar, i identifikuar nepermjet leternjoftimit-elektroni, Nr. Personal J50727141F.**

1. Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Ortaku i vetëm ose nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

2. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

3. Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

4. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur.

5. Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me këtë statut:
  - a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejn regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
6. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
7. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij.
8. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.
9. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
10. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.
11. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të këtij ligji.

#### NENI 11 PËRFAQËSIMI

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
2. Administratori, që përfaqëson një bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
3. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.

4. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
5. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
6. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
7. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
  - a. numrin unik të identifikimit;
  - b. formën ligjore të shoqërisë;
  - c. vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
  - d. të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
  - e. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

NENI 12

Cdo gjë që tjetër dhe/ose më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (Q.K.B) me qëllim jo vetëm regjistrimi.

## THEMELUESIT I SHOQËRISË

“VËLLEZËRIT BARDHI” Sh.p.k.

Agim Bardhi



Arben Bardhi



Besnik Bardhi



Arjan Bardhi

